BASHKIA FIER
DREJTORIA E PROJEKTEVE TE INFRASTRUKTURES

Adresa: L. “Kastriot”; Rruga “Ramiz Aranitasi”; Nr.15 Fier – SHQIPËRI Tel. + 355 34 410 650 ëebsite:bashkiafier.gov.al

RAPORTI TEKNIK

Haxhi Avdullai
Digitally signed by Haxhi Avdullai
Date: 2019.07.25 12:09:16 +02'00'

OBJEKTI: RIKONSTRUKSIONI I RRUGES "JAKOV MILE"

PROJEKT ZBATIMI

Fier 2016

1. TE PERGJITHSHME, GJENDJA EKZISTUESE

1.1 VENDNDODHJA E OBJEKTIT

Rruga "JAKOV MILE" është pjesë kryesore kompozicionale e zhvillimit radial të sistemit rrugor të qytetit të Fierit. Zona e marrë në studim përfshihet në vijë lineare 350ml. Rruga **"JAKOV MILE"** ndodhet ne lagjen "APOLLONIA". Kjo rruge kryqezohet ne vije lineare ne jug-perendim me rrugen "BRIGADA E IX SULMUESE" ndersa ne veri-lindje kryqezohet me rrugen "Mujo ULQINAKU" *(shih hartën bashkëlidhur).*



Fillimi i kesaj rruge ndodhet 615 m larg nga qëndra e qytetit ose sheshi "NENE TEREZA".Në gjatësinë e saj ndodhet shkolla publike "Mark Dashi". Në gjatësine e saj gjithashtu operojne një numër i madh njësish tregtare .

1.2 GJËNDJA EKZISTUESE

Gjendja ekzistuese e rrugës:

Ka gjatesi rreth 350 ml dhe gjeresi variabel 10-12ml. Rruga eshte e shtruar me shtrese asfaltobetoni e cila eshte pjeserisht e demtuar dhe ka disnivele ne te gjithe gjatesine, kunetat anesore te rruges jane te demtuara ne rreth 50% te gjatesise se rruges. Rruga eshte e konturuar me bordura betoni, te cilat jane pjeserisht te demtuara dhe me disnivele.

Ne te dy anet e rruges shtrihen trotuare me gjeresi qe varion nga 1.7-11 m, ne gjendje jo te mire, te cilet jane te shtruar me materiale te ndryshme, pjeserisht me shtrese betoni, pjeserisht me pllaka cimento te amortizuara, pjeserisht me pllaka betoni te shtruara nga bizneset perreth. Shtresat e trotuarit ne te gjithe gjatesine jane me disnivele te ndryshme.

Ne te gjithe gjatesine e rruges nuk ka Shimbledhesa, por ka vetem ne kryqezimet e rrugeve, te cilet nuk funksionojne mire.Ujrat e shiut rrjedhin ne gjendje te lire sipas pjerresise se rruges, duke krijuar probleme ne kete aks rrugor dhe ne rruget terthore. Nga informacioni i marre nga ndermarja e UK. Sha , sistemi i K.U.Z. eshte pothuajse inekzistent ne kete rruge, ndersa linjat e ujesjellesit kane nevoje per risistemim.

Gjelbërimi

Llojet e pemëve që ndodhen aktualisht janë, shelg, dhe lloje te ndryshem rrapenjsh. Rruga nuk është e gjelbëruar në të gjithë gjatesinë e saj në mënyrë uniforme. Disa segmentë të rrugës, kryesisht si rrjedhojë e zhvillimit të bizneseve, janë të zhveshur nga gjelbërimi. Ne keto kushte keto drure duhet te hiqen dhe te mbillen drure dekorative uniforme ne te gjithe gjatesine e rruges.

Ndricimi

Linja e ndricimit e rruges “Rauf Nallbani“ eshte e instaluar ne te dy krahet e rruges ne te gjithe gajtesine e saj qe fillon nga qendra dhe perfundon tej stacionit te trenit. Shtyllat e ndricimit jane celiku me gjatesi 6.5m te vendosura ne tortuar ne forem zik-zake ne largesi 50m nga njera tjetra. Ne performancen e kesaj rruge ka pasur probleme te ndryshme, te cilat lidhen sidomos me amortizimin total te armaturave ndricuese, si edhe mungesa te tyre ne disa shtylla. Korrodimi dhe nxjerrja jashte pune e tokezimeve te shtyllave nga perdorimi i gjate.

Ne disa pjese linjat kabllore te ushqimit te shtyllave jane te demtuara dhe armaturat ndricuese jane te furnizuara nepermjet lidhjeve provizore jashte kushtet teknike te ndricimit. Po keshtu te gjitha morseterite e shtyllave me mbrojtjet perkatese jane koplet te demtuara, Linja e

ndricimit te kesaj rruge komandohet nga dy pika lidhje. Panelet elektrike te komandimit te ndricimit jane te amortizuar dhe jashte kushteve teknike. Ne keto kushte del e domosdoshme linja e ndricimit publik te kesaj rruge te realizohet krejtesisht me aksesore te rinj.

Foto të gjëndjes ekzistuese të rruges "Jakov Mile"

1.4 QËLLIMI I PROJEKTIT

Qëllimi kryesor është ripërtëritja urbane e zonës së marrë në studim dhe qendrueshmëria e zhvillimit mjedisor, ekonomik dhe kulturor.

Objektiva të tjerë:

- Qytet më atraktiv për qytetarët dhe turizmin.
- Shtimi i zonës së gjelbërt
- Lirimi i hapsirave publike

Koncepti i ndërhyrjes lidhet ngushtë me rrugën dhe tenton të japë alternative për të përfituar më tepër hapësirë. Rikonceptimi bëhet me qëllim kthimin e kësaj zone në një zonë me karakter social-kulturor, përmirësimit të dimensioneve të rrugës, të strukturës dhe të infrastrukturës, në përputhje me standartet bashkëkohore.

Rehabilitimi i bllokut dhe rikonstruksioni tërësor i trupit të rrugës

Studimi dhe plani i vendosjes të bëhet në bazë të kritereve aktuale të zhvillimit të hapsirave për lëvizjen e mjeteve të transportit. Normat dhe konceptimi arkitektonik të udhëhiqen nga parimi i sigurisë së

lëvizjes në rrugë, duke ndjekur objektivat e një lëvizjeje racionale, i mbrojtjes së mjedisit dhe i kursimit të energjisë.

Kontenier

Ne te gjithe gjatesine e rruges, te parashikohet lenia e vendeve per konteniere te mbetjeve urbane sipas normativave, duke bashkepunuar me specialistin e mjedisit.

Gjelbërimi

Ne te gjithe gjatesine e rruges te parashikohet gjelbërimi me drurë decorative, lloji i të cilave do të përcaktohet në bashkëpunim me specialistët e gjelbërimit.Te parashikohet edhe ndertimi i siperfaqeve te gjelberta ne trotuare sipas studimit.

Sinjalistika

Ne te gjithe gjatesine e rruges te parashikohet sinjalistika horizontale dhe vertikale, e cila te hartohet sipas kerkesave te Kodit Rrugor.

Punoi:

ark. Erigels Myrtaj